



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 07.04.2021

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.03.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Berisha Com" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-sanimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza", me Nr. të Prok: 632-21-1371-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- II. 1. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik "Berisha Com" SH.P.K., e dt.31.03.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi-sanimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza", me Nr. të Prok: 632-21-1371-5-1-1, Nr. Brendshëm 632—21-022-511, kundër **Dosjes së tenderit**, te AK –së, të datës 22.03.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet **DOSJA E TENDERIT E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, e publikuar me datë: 22.03.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Meqë Operatori Ekonomik " Berisha Com " SH.P.K, ka **parashtruar** kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi-sanimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza", me Nr. të Prok: 632-21-1371-5-1-1, Nr. Brendshëm 632—21-022-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 07.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se kërkesat e Autoritetit kontraktues sipas pikës 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së tenderit janë në kundërshtim me LPP-në, nuk qëndron sepse këto kritere janë vendosur në pajtim me nenin 68 paragrafi 1 dhe neni 69 paragrafi 6.2, të LPP-së, prandaj pretendimi juaj është i pabazuar.

Pretendimi juaj se duhet të hiqet kriteri sipas të cilit kërkohet që Operatorët ekonomik duhet të jenë të pajisur me ISO DS CEN TR 15128 2015, aprovohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Arkivit të Komunës

z.Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

